

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, anëtare e trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Dritan Nushi, pasi kam vlerësuar se ai nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kusht ky i përcaktuar në nenin 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, me arsyetimin sa vijon:

1. Për sa i përket automjetit tip “Daimler Chrysler” në përdorim

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka përdorur automjetin e motrës së tij për disa udhëtime jashtë vendit.

Subjekti ka paraqitur prokurën e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.11.2016, me anë të së cilës shtetasja B. N., motra e subjektit, e ka autorizuar subjektin e rivlerësimit ta përdorë këtë automjet pa asnjë kufizim brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një afat të pakufizuar.

Referuar situatës faktike të përdorimit të automjetit prej subjektit të rivlerësimit nga prokura e mësipërme, konfirmohet përdorimi i këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit edhe në kohën e plotësimit të deklaratës *Vetting*.

Subjekti kishte detyrimin ta deklaronte këtë marrëdhënie, në zbatim të përcaktimeve të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit përcaktohet se: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”*.

Për sa më sipër, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting* duke mos e deklaruar përdorimin e këtij automjeti prej tij.

Nga sa ka rezultuar se ekziston marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me automjetin për shkak të përdorimit sipas prokurës së posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.11.2016, subjekti kishte detyrimin të provonte kohën dhe vlerën e blerjes së këtij mjeti nga motra e tij, si dhe mundësinë financiare të saj lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie për të provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se nuk ndodhej në kushtet e parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

2. Për sa i përket banesave në përdorim të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se:

- nga fillimi i vitit 2004 deri në fund të vitit 2005 ka jetuar në Tiranë, te ky apartament i prindërve, ndodhur në rrugën “****”, p. ***, kati 1 i banimit, i prenotuar nga babai i tij në vitin 2002;
- së bashku me bashkëshorten, nga viti 2006 deri aktualisht përdor shtëpinë në pronësi të vjehrrit, me sip. 93 m², blerë në vitin 2001, ndodhur në rrugën “****”.

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe pyetësorit vijnë në kundërshtim me deklaratimet periodike ndër vite, në të cilat rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi për vitet 2003 – 2004 apartament me qira në rrugën “****” dhe nga viti 2005 ka deklaruar se banon në banesë në rrugën “****”.

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me përdorimin e apartamentit në pronësi të vjehrrit vijnë në kundërshtim me dokumentacionin dhe faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ, ku ka rezultuar se me prokurën datë 3.7.2014, vjehrrin e subjektit të rivlerësimit i ka dhënë vajzës së tij/bashkëshortes së subjektit të drejtën për të disponuar apartamentin nr. 25, me sip. 93 m² (apartamenti ku subjekti ka deklaruar se banon pa ndërprerje prej vitit 2006, ka rezultuar i dhënë me qira me kontratën e datës 3.7.2014 dhe kontratën e huapërdorjes datë 10.9.2015).

Citimi i numrit të kontratës së furnizimit me energji elektrike nr. ***, Tiranë, si numri në të cilin qiramarrësit do të paguanin energjinë elektrike, rrëzon pretendimet e subjektit se ky apartament u përdor ndër vite nga subjekti i rivlerësimit dhe se referimet e të dhënave ishin pasaktësi në hartimin e dokumentacionit ligjor në kontratën e qirasë.

Deklarimet kontradiktore të subjektit gjatë procesit krahasuar me deklaratimet periodike të tij, si dhe dokumentacionin e përfutur nga hetimi administrativ mbi vendqëndrimin e tij gjatë periudhës krijojnë paqartësi dhe nuk provojnë se ku ka jetuar realisht subjekti i rivlerësimit ndër vite.

Për sa kohë vetë subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore, është e pamundur të dallohet se cili deklaratim është i vërtetë dhe cili ka qenë shkak i vërtetë që e ka detyruar subjektin e rivlerësimit, për të mos respektuar kërkesat urdhëruese të ligjit për të deklaruar saktësisht vendbanimet.

Gjatë procesit të hetimit administrativ, rezultoi gjithashtu se:

- i. Subjekti deklaroi në vitin 2010 pronësi të 1/3 pjesë takuese të tij në apartamentin me sip. 153 m², i pahipotekuar në Tiranë, në adresën: nj. ***, rr: “****”, p. ***, ap. 7.
- ii. Në kontratën e shitblerjes së automjetit në datën 9.6.2003, subjekti ka deklaruar si adresë banimi këtë apartament të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.
- iii. Kontrata përfundimtare e shitblerjes lidhur për këtë apartament mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe nënës së subjektit u hartua në vitin 2012, në një kohë kur sipas vendimit nr. ***, datë 10.10.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shoqëria “****” sh.p.k. ishte shoqëri e likuiduar dhe në një kohë kur subjekti deklaroi në vitin 2010 se apartamenti ishte në bashkëpronësi të tij nënës dhe motrës, referuar dëshmisë së trashëgimisë.
- iv. Deklarimi i subjektit se ky apartament përdorej prej familjarëve nga viti 2005, mbeti vetëm deklarativ dhe i paprovuar me dokumentacion ligjor, referuar punësimit të prindërve dhe marrëdhënies së tyre të vazhdueshme të jetesës dhe punës në qytetin e Fierit, por dhe sa nga hetimi rezultuan fakte që kundërshtonin këtë deklaratim të subjektit. Babai i subjektit në nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së automjetit në vitin 2006 deklaroi si adresë banimi të tij rrugën “****”. Nëna e subjektit, në hapjen e kontratave për shërbime bankare me Bankën Kombëtare Tregtare, deklaroi gjithashtu adresë banimi në vitin 2017 rrugën “****”.

- v. Referuar dokumentacionit ligjor provues të administruar për familjen e subjektit për periudhën 1993 – 19.10.2002, kohë e pretenduar si kohë e pagimit të shumës 50.000 USD, nuk u provua mundësia financiare e tyre që me burime të ligjshme të investonin në këtë pasuri të paluajtshme sipas analizës së mëposhtme:

Përshkrimi	1993 – 19.10.2002
Të ardhurat e familjes së subjektit për periudhën	4,572,724
Të ardhura nga paga e babait nga viti 1993	1,563,944
Të ardhura nga paga e nënës nga viti 1994	1,064,781
Të ardhura nga paga e subjektit nga viti 1998	1,653,998
Të ardhura nga kthimi në firmat piramidale	290,000
Të ardhura nga aktiviteti privat i babait	-
Detyrime	0
Shpenzimet e familjes së subjektit për periudhën	3,686,626
Shpenzime jetike	2,396,626
Shuma të investuara në firmat piramidale 11.2.1997	1,290,000
Pasuri	6,973,000
Apartament rruga “***”, më 19.10.2002, paguar 50,000 USD	6,973,000
Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri	-6,086,902

Subjekti i rivlerësimit, pjesë e certifikatës familjare deri në dhjetor 2005, duhet të deklaronte në deklaratat periodike të viteve 2004 – 2005 të plotësuar prej tij, pagimin e pjesës më të madhe të çmimit të krijimit të kësaj pasurie në vitin 2002, dhe marrëdhënien e tij dhe familjes me këtë apartament, deklarim i cili nuk është kryer në kundërshtim me detyrimet e ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar.

Për sa rezulton se subjekti dhe familja e tij ishin në pamundësi financiare për ta justifikuar këtë apartament me burime të ligjshme që në momentin e krijimit të saj, arsyetimi se çmimi i blerjes së kësaj pasurie është paguar në vitin e parë të subjektit në detyrë, nuk i shërben në mënyrë domethënëse situatës konkrete të subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë se ndonëse jo në detyrën e prokurorit ai ka kryer funksionet e oficerit të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë, në periudhën 1998 – 2002.

Në rastin konkret, përveç mungesës së koherencës në deklarime lidhur me vendbanimet, subjekti i rivlerësimit duhet të provonte burimin e ligjshëm të kësaj pasurie për të provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se nuk ndodhej në kushtet e parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit z.Dritan Nushi lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi vlerësoj se subjekti nuk arrin nivel të besueshëm, në kuptim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Xhensila PINE
Anëtare (kundër)